



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 253, datë 12.11.2019

PËR
SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...},
I DIPLOMUAR PËR MAGJISTRAT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS
DHE REFUZIMIN E EMËRIMIT TË TIJ SI GJYQATAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 12.11.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin e kandidatit z. {...} dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2018-2019, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës me Shkresën nr. 625 prot., datë 03.07.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3596 prot., datë 03.07.2019.

2. Me Vendimin nr. 103, datë 05.07.2019, mbështetur në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët e diplomuar në Shkollës së Magjistraturës në përfundim të vitit akademik 2018-2019, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relatore u caktua znj. Marçela Shehu.

3. Më datë 05.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z., në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishite për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidati z{...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 08.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati z{...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.07.2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu kërkuar të dhëna mbi punësimin/et e tij, të dhëna këto që u dërguan nga kandidati, në rrugë elektronike, brenda të njëjtës ditë.

8. Më datë 09.07.2019, pas marrjes nga ISSH të të dhënave të punësimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, u kërkuar informacion nga Subjekti ALDI sh.p.k që ka mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}.

9. Gjatë procedurës së verifikimit, në datat 10.07.2019, 11.07.2019 dhe 26.07.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, u konstatua se në të mungonin vetëdeklarimet e kandidatit

në lidhje me tre prej kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Konkretisht mungonin vetëdeklarimet në lidhje me anëtarësinë në parti politike, me disiplinën në punë (qënien ose jo i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për pasjen ose jo masë disiplinore në fuqi), si dhe me qënien ose jo bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë, me datë 08.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët e vetëdeklarimeve që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

12. Brenda afatit treditore, kandidati z. {...} depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët përkatës të vetëdeklarimeve.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTIN DHE KRITERET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR EMËRIM SI GJYQ TAR

A. Për kushtin e emërimit si gjyqtar

1. Sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës¹ së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit të Statusit², për t'u emëruar gjyqtar kërkohet përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe diplomimi, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

2. Bazuar në Vendimin nr. 3, datë 01.07.2019, të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë me Shkresën nr. 625 prot., datë 03.07.2019, si dhe dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjellë me Shkresën nr. 635 prot., datë 04.07.2019, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati në fjalë ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2016 - Qershor 2019 dhe në përfundim të vitit akademik 2018 - 2019 është diplomuar për magjistrat, profili gjyqtar :

a) me 88.21 % të pikëve, pra *"është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme"*;

b) është vlerësuar me 563.32 pikë, domethënë "mirë", për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *"është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar"*.

3. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit si gjyqtar.

B. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

¹ "1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.
2. Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj".

² "1. **I diplomuari** emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: ...".

1. Kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit, përcaktohen si kritere të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sikundër po ashtu, sipas neneve 64 dhe 66 të këtij ligji, ato përcaktohen edhe si kritere zgjedhshmërie, pra si kritere që magjistrati (gjuqtari) do të duhet t'i plotësojë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit.

2. Verifikimi në këtë rast i kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit merr shkas nga fakti se kandidati z. {...} i është pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Statusit, por edhe të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përmes të cilëve kanë pësuar ndryshime kritere dhe rregullat e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, më tej, edhe ato për emërimin e të diplomuarve në këtë shkollë për magjistratë.

3. Gjithsesi, në respektim të parimit të sigurisë juridike, në lidhje me verifikimin e kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, u mbajt në konsideratë ligji i kohës së pranimit të kandidatit z. {...} në programimin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra Ligji nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullorja e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji. Po ashtu u mbajt në konsideratë edhe ligji aktual në fuqi, pra Ligji i Statusit. Konsiderimi në këtë rast i rregullimeve sipas këtyre dy ligjeve konsiston në atë se vetëm për kritere që nuk ka ndonjë përcaktim konkret në ligjin e kohës së pranimit në formimin fillestar, kandidati do të duhet të përmbushë këto kritere sipas ligjit aktual në fuqi.

4. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikuan këto kritere:

a) zotësia e plotë për të vepruar. Për këtë kriter, ndërsa është verifikuar edhe në momentin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) shtetësia shqiptare. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 05.03.2009, ku pasqyrohet edhe përberësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”.

Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 16.10.2019, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas çertifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) arsimimi. Për këtë kriter, në rastin e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, kandidati ka depozituar Diplomë Bachelor në Drejtësi nr. {...} lëshuar me datë nga Shkolla e Lartë Universitare Private “Luarasi” Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë, dhe {...} suplementi i diplomës, lëshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Private “Luarasi” Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë; Diplomë Master i Shkencave në Drejtë Penale nr. {...} lëshuar me datë {...} nga Shkolla e Lartë Universitare Private “Luarasi” Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë, dhe suplementi i diplomës, lëshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Private “Luarasi” Tiranë.

Vlen të theksohet se për këtë kriter mbahet në konsideratë verifikimi i bërë nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimit në provimin e pranimit për në formimin fillestar, sipas përcaktimeve të ligjit të kohës, pra sipas Ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”;

ç) gjendja gjyqësore. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 23.08.2016. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr. V-2531/1 prot., datë 05.08.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

d) disiplina në punë. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas informacionit të marrë nga ISSH, më datë 09.07.2019, u konstatua se ai ka qenë i punësuar pranë Subjektit “ALDI” Person Fizik në Kurbin.

Ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua shkresa datë 21.10.2019, e Subjektit ALDI sh.p.k, sipas të cilës kandidati nuk është i larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo nuk ka masë disiplinore në fuqi;

dh) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qënien e kandidatit anëtar i ndonjë partie politike;

e) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Për këtë kriter u mbajt në konsideratë moshja e kandidates (i datëlindjes 13.09.1990), çka bën të panevojshëm verifikimin e këtij kriteri pranë autoritetit të ngarkuar nga ligji (Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), sikurse përcaktohet edhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019:

ë) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk ka qenë dhe nuk është bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qënien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

5. Sa i përket kriterit të përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet, sipas shkronjës “ç”, të nenit 28, të Ligjit të Statusit, ky kriter është i paaplikueshëm për këtë kandidat për shkak se nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që kandidati ka përfunduar programin e formimit fillestar dhe është diplomuar tashmë.

6. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kriteret e kandidimit/emërimit si gjyqtar, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

C. Për kriterin e pasurisë

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 55/34 prot., datë 23.09.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar:

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” konstatohet se për kandidatin {...} :

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar burim financiar të pasurive;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

ILDKPI ka arritur në këtë përfundim për shkak se ka konkluduar në:

- Mosparaqitje të dokumentacionit ligjor për të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve si tregtar ambulant, të ardhura të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me vlerë 9.000.000 lekë, sip. 77.97 m², rruga “Grigor Heba”, Tiranë. Gjithashtu me të ardhurat nga aktiviteti i tyre privat si shitës ambulant fruta-perime, kanë mundësuar përveç pagesës së apartamentit të mësipërm edhe ndërtimin e shtëpisë së tyre të banimit me 2 kate në Tiranë, pagesën e shkollimit të kandidatit në universitetin jopublik, si dhe kanë përballuar shpenzimet për konsum familjar ndër vite.

2.3 Më datë 25.09.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreu IX, Seksionin A, pika 11, shkronja b, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:
- për përfundimin e raportit të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

2.4. Brenda afatit ligjor, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e ILDKPKI-së, duke parashtruar ndër të tjera se: *“Më lejoni të sqaroj faktin se që prej vitit 1990, prindërit e mi kanë ushtruar veprimtari tregtare ambulante në disa tregje të lira, në qytete të ndryshme si Laç, Milot, Korçë dhe Tiranë. Ky aktivitet tregtar është ushtruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi gjatë asaj periudhe. Në atë periudhë, kjo kategori tregtarësh shiste në treg të lirë duke paguar tarifafat prej 100-200 lekë çdo ditë (në varësi të hapësirës që shfrytëzonin). Në atë periudhë, ata nuk ishin të detyruar sipas legjislacionit në fuqi të regjistroheshin në ndonjë institucion shtetëror. Pra, nuk ishin të detyruar që të regjistroheshin në gjykatë (siç ishte për shoqëritë tregtare) dhe as në ndonjë institucion tjetër shtetëror të ngjashëm me QKB-në sot. Gjithashtu, sipas legjislacionit në fuqi, kjo kategori tregtarësh nuk ishte e detyruar as të deklaronte balance në zyrën e tatimeve. Përndryshe organet shtetërore nuk do i lejonin që të ushtronin veprimtarinë tregtare. Të vetmin detyrim që kishin këta tregtarë ishte pagimi i tarifës/taksës në momentin që futeshin në tregun e lirë për të shitur mallrat e tyre. Siç edhe u përmend mësipër, taksa/tarifa varionte nga 100200 lekë (3,000 – 6,000 në muaj ose 36,000 – 72,000 në vit) në varësi të hapësirës që shfrytëzohej. Ndërsa për ata tregëtarë të vegjël, të cilët kishin edhe mjete transporti ishte e detyrueshme të ishin të licencuar për të transportuar mallra dhe të paguanin taksat dhe tarifafat që lidhen me dokumentacionin e mjeteve të transportit detyrim të cilin babai im e ka përmbushur, sikurse vërtetohet nga autorizimi administrativ nr. 276/2002 i Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Zyra e Punësimit Lezhë, lëshuar subjektit fizik (transport mallrash) {...}, bashkëlidhur deklaratës së dorëzuar në ILDKPKI.*

Lidhur me provueshmërinë e ushtrimit të kësaj veprimtarie tregtare ambulante, duke qenë se tregu ambulant ka qenë në varësi të organeve të qeverisjes lokale, babai im {...}i është drejtuar për këtë qëllim Bashkisë Laç me kërkesën për informacion rreth ushtrimit nga ana e tij të aktivitetit tregtar, si psh. bileta për tezgat në treg, akt marrëveshje mes tij dhe Bashkisë Laç. Me shkresën nr. 3707 prot., datë 02.08.2019 Bashkia Laç është përgjigjur se për periudhën 1993 – 2005 nuk ka të ruajtuara dokumenta arkivore. Nga ana tjetër, rezulton se në QKB veprimtaria tregtare është regjistruar më datë 07.09.2012 në emër të babait tim {...}, vit prej të cilit janë deklaruar rregullisht të ardhura, siç pranohet edhe nga ILDKPKI.

Përsa më lart, lidhur me të ardhurat nga kjo veprimtari, sqaroj se gjatë këtyre viteve prindërit e mi kanë gjeneruar të ardhura, të cilat kategorizohen në grupin e të ardhurave “të ulta-të mesme”. Me këto të ardhura, është përballuar jetesa e përditshme, shkollimi i motrës dhe i imi, strehimi i familjes etj. Janë pikërisht kursimet e këtyre viteve, si dhe përfitimet nga interesat bankare që kanë rrjedhur prej tyre, ato për të cilat ILDKPKI është shprehur se nuk është dorëzuar dokumentacion i plotë ligjor. Konkretisht, sikurse është pasqyruar në deklaratën e pasurisë së dorëzuar pranë ILDKPKI-së, fillimisht shuma e kursimeve nga veprimtaria tregtare e prindërve ka qenë 400.000 lekë. Kjo shumë është depozituar në ish Bankën e Kursimeve përpara vitit 1997 në një llogari në emër të nënës time {...}. Më pas, shuma fillestare e depozituar si më lart, është shtuar vit pas viti nga përfitimet prej interesave bankare. Në këtë pikë, shtoj faktin se përgjatë atyre viteve, deri në momentin e tërheqjes së shumës totale të parave në vitin 2004, interesat bankare kanë qenë

relativisht të larta. Për këtë, shuma totale e kursimeve të akumuluar deri në vitin 2004, periudhë kur është bërë tërheqja bankare, ka qenë rreth 2,000,000 lekë. Kjo shumë është depozituar në llogari të tjera bankare, sipas deklarimeve të bëra prej meje në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI.

Lidhur me depozitën fillestare prej 400.000 lekësh në ish Bankën e Kursimeve, prej së cilës janë gjeneruar edhe interesat bankare si më lart, në mungesë të ruajtjes së dokumentacionit nga prindërit e mi, nëna ime {...}, ka kërkuar informacion në Raiffeisen Bank, si banka sukseduese, të cilin kjo bankë nuk e ka dhënë. Me shkresën "Vërtetim" të lëshuar prej saj më datë 12.06.2019 ajo shprehet se nuk disponon të dhëna në lidhje me llogaritë/depozitat përpara datës 01.10.2004."

2.5 Me shkresën nr. 3788/18 prot., datë 01.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar kërkesë ILDKPI-së për informacion shtesë në lidhje me kandidatin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës z. {...}, duke i përcjellë dhe dokumentacionin përkatës.

2.6 Me shkresën nr. 3332/13 prot., datë 09.10.2019 ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin, duke konkluduar se për kandidatin z. {...} :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) nuk ka dokumentacion të plotë ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Në këtë raport, për kandidatin, {...} konstatohet:

"Mosparaqitje të dokumentacionit justifikues financiar për të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve si tregtar ambulant, të ardhura të cilat kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e apartamentit me vlerë 9.000.000 lekë, sip. 77.97 m2, rruga "Grigor Heba", Tiranë. Gjithashtu përveç pagesës për blerjen e apartamentit të mësipërm, prindërit kanë mundësuar ndërtimin e shtëpisë së tyre të banimit me 2 kate në Tiranë, pagesën e shkollimit të dy fëmijëve, si dhe kanë përballuar shpenzimet për konsum familjar ndër vite."

Lidhur me këtë konstatim, rezulton se kandidati {...}, në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit, në pjesën e të dhënave konfidenciale ka deklaruar:

"Apartament banimi me sipërfaqe 77.97 m2, së bashku me shtesën anësore (ballkon) të ndërtuar nga shitësi (aktualisht në process legalizimi) adresa ; rruga "Grigor heba" godina nr. 12, hyrja nr. 1, apartamenti nr. 2 Tiranë, blerë më 09.11.2016. Çertifikatë "Për vërtetim pronësie" nr. {...} data e lëshimit {...}.

Burimi i krijimit : *Kursimet e prindërve {...} dhe {...}, të depozituara ndër vite në bankë. Fillimisht shuma e kursimeve ka qenë përafërsisht 400.000 lekë, e cila është depozituar në ish Bankën e*

Kursimeve përpara vitit 1997 në një llogari në emër të ime më, {...} (për të cilën Raiffeisen Bank nuk jep informacion, shiko vërtetimin bashkëlidhur deklaratës. Kontratë nr. {...}rep., nr. {...}kol., datë {...}.”

Shuma e kursimeve është shtuar nga përfitimet e interesave bankare dhe rreth vitit 2004, kur kursimet janë tërhequr, shuma totale e kursimeve ishte 2.000.000 lekë. Kjo shumë është depozituar sërish në disa llogari në banka të ndryshme në emër të babait ({...}) dhe të nënës ({...}). Kontratë nr. {...} rep., dhe nr. {...}kol., datë {...}.

Në momentin e blerjes së apartamentit shuma e këtyre kursimeve ka qenë përafërsisht 4.500.000 lekë. Burimi i krijimit fillestar i këtyre kursimeve është veprimtaria tregtare e prindërve si shitës ambulant në disa tregje të lira në Laç, Milot, Korçë dhe Tiranë pas vitit 1990. Deklaratë noteriale nr. {...} rep., n. {...}kol., datë {...}.

Më pas veprimtaria tregtare si shitës ambulant është regjistruar në QKB më 07.09.2012 në emër të babait {...}. Gjithashtu si burim krijimi për kursimet e mësipërme janë edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit në pronësi të {...} dhe {...}, me sipërfaqe 50.05 m2, adresa : lagja nr.1, pallati nr. 1, shkalla nr. 5, kati nr. 3, apartamenti nr. 32, Laç. Çdo vit kursimet janë shtuar me përfitimet e të ardhurave nga interesat bankare. Deklaratë noteriale nr. {...} rep., nr. {...} kol., datë {...}.

Të ardhurat nga paga e motrës {...} ({...}) e punësuar si mjeke nga qershori i vitit 2012 pranë Qendrës Shëndetsore Laç, Qendrës Shëndetsore Milot dhe Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” në shumën përafërsisht 2.000.000 lekë. Deklaratë noteriale nr. {...} rep., nr. {...} kol., datë {...}.

Huaja e marrë nga prindërit {...}dhe {...}nga djali i tezes {...}në shumën 1.500.000 lekë (shlyer pjesërisht 800.000 lekë me këto kursime të ngelura nga veprimtaria tregtare e babait). Huaja e marrë nga prindërit {...}dhe {...}nga halla (motra e babit) {...}dhe bashkëshorti i saj {...}në shumën 3.000.000 lekë.”

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, të apartamentit të banimit me sipërfaqje 77.97 m2, në pronësi të kandidatit {...} dhe të deklarimeve të kandidatit, ILDKPI ka konstatuar se:

- **Burimi i krijimit të shumës 9.000.000 lekë për pagesën e apartamentit nga ana e prindërve, sipas deklarimeve të kandidatit, përbëhet nga :**
- Të ardhurat e prindërve si shitës ambulant prej vitit 1990 të cilat llogariten rreth 2.300.000 lekë.
- Të ardhurat e motrës së kandidatit 2.000.000 lekë.
- Hua në shumën 4.500.000 lekë, nga e cila prindërit kanë shlyer 800.000 lekë.
- Shitje apartamenti në Laç, në shumën 200.000 lekë.

- *Sipas deklaratimit, burimi i krijimit fillestar të kursimeve të prindërve, është veprimtaria tregtare e tyre si shitës ambulant në disa tregje të lira në Laç, Milot, Korçë dhe Tiranë pas vitit 1990.*
- Kandidati ka paraqitur përgjigje nga Bashkia Laç sipas së cilës, nuk kanë të ruajtura dokumenta të arkivuara për periudhën e viteve 1993- 2005.
- Sipas statement bankar të paraqitur, për llogarinë rrjedhëse të {...}, figuron pagesa e taksave vendore në vitin 2005.
- Nga viti 2012, aktiviteti figuron i regjistruar në QKB.
- Organet tatimore nuk konfirmojnë të ardhura/fitim nga aktiviteti privat i prindërve, para vitit 2014 dhe për periudhën 2014 – 2016, fitimi pas tatimit nga aktiviteti i prindërve është rreth 540.000 lekë.
- *Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton depozitë bankare rreth 1.100.000 lekë në emër të prindërve.*
- *Lidhur me kursimet në vlerën 2.000.000 lekë nga puna e motrës, konstatohet se deri në vitin 2015 ajo ka qenë e punësuar në Laç dhe Milot.*
- *Gjithashtu rezulton se prindërit kanë ndërtuar një godinë banimi 2 kate, me sipërfaqje parcele ndërtimore 421 m2, sipërfaqe ndërtimi 113.5 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi për banim 247.3 m2 me adresë NJ.B nr. 6 Bashkia Tiranë, për të cilën është marrë leje legalizimi nr. {...}, datë {...} nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Tirana 1, dhënë {...}. Sipas vërtetimit nga Bashkia Tiranë, datë {...}, {...} {...} është banor në këtë banesë.*
- *Sipas informacioneve paraprake, kandidati ka përfunduar studimet e larta universitare në SHLUJ Luarasi, çfarë do të thotë se janë paguar shpenzime ekstra për këtë shkollim gjatë viteve 2010 – 2015, rreth 20.000 euro.*

Në këto kushte, ILDKPI ka konstatuar se:

Kandidati nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues financiar për të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve si tregtarë ambulantë, të ardhura të cilat kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e apartamentit me vlerë 9.000.000 lekë, sip. 77.97 m2, rruga “Grigor Heba” Tiranë. Gjithashtu, përveç pagesës për blerjen e apartamentit të mësipërm, prindërit kanë mundësuar ndërtimin e shtëpisë së tyre të banimit me 2 kate në Tiranë, pagesën e shkollimit të dy fëmijëve, si dhe kanë përballuar shpenzimet për konsum familjar ndër vite.

2.7 Më datë 16.10.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i njohur me materialet dhe duke e konsideruar gjetje të procedurës së verifikimit të pasurisë

konkluzionin e sipërcituar, sipas përcaktimeve të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Seksionit A, Kreu IX të Vendimit nr. 75 datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” ka vendosur mbi njoftimin e kandidatit {...} {...} mbi gjetjen e procedurës së verifikimit duke e ftuar për të paraqitur shpjegime si dhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

2.8. Me datë 17.10.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin përfundimtar të ILDKPKI-së si më poshtë :

“Lidhur me konkluzionin e parë, ILDKPKI, në Aktin me nr. 3332/13 prot., datë 09.10.2019, sërish është shprehur se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin. Sikurse kam theksuar në Memorandumin Shpjegues të datës 26.09.2019, rezulton se nga përmbajtja në tërësi e aktit përfundimtar të kontrollit të ILDKPKI-së, nuk kuptohet se cila pjesë e deklarimit nuk është e saktë në përputhje me ligjin. Kjo për arsye se, ILDKPKI në të gjitha rubrikat, në konkluzion është shprehur se: “...Përputhet deklarimi i kandidatit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur...”. Duke qenë se ky konkluzion nuk arrihet të kuptohet qartë, kërkoj që të mos merret në konsideratë nga ana juaj.

Lidhur me konkluzionin e dytë, më lejoni të konstatoj faktin se tashmë në aktin e rishikuar të ILDKPKI-së me nr. 3332/13 prot., datë 09.10.2019, konkludohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive, ndryshe nga konkluzioni i mëparshëm, ku evidentohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive. Tashmë është e qartë edhe nga vetë ILDKPKI, se burimet financiare për pasurinë në fjalë janë të ligjshme, si dhe për pjesën më të madhe të tyre, dokumentacioni ligjor është paraqitur. Nga ana tjetër, konkludohet se për një pjesë të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, nuk ka dokumentacion të plotë ligjor.

Lidhur me këtë, sikurse kam parashtruar edhe në Memorandumin Shpjegues të datës 26.09.2019, për shkaqe tërësisht objektive dhe të pavarura nga unë, nuk ka qenë e mundur sigurimi i një dokumentacioni të plotë ligjor.

Për sa më lart, më lejoni të ritheksoj faktin se në përmbushje të barrës për të provuar ligjshmërinë dhe justifikimin e pasurisë në pronësisë time, kam ndërmarrë një proces të gjatë të kërkimit dhe mbledhjes së dokumenteve justifikuese të të ardhurave të prindërve të mi, për një periudhë kohore që nga viti 1990 deri në vitin 2016. Për këtë, kam marrë të gjithë hapat dhe masat e mundshme ligjore për të kërkuar të gjithë dokumentacionin e mundshëm lidhur me ushtrimin e veprimtarisë tregtare të ushtruar prej tyre.

Lidhur me depozitën fillestare prej 400.000 Lekësh në ish-Bankën e Kursimeve, prej së cilës janë gjeneruar edhe të ardhurat që rrjedhin nga interesat bankare që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit (rreth 1.600.000 Lekë), në mungesë të ruajtjes së dokumentacionit nga prindërit e mi, më lejoni të rikthejoj se nëna ime {...}ka kërkuar informacion në Raiffeisen Bank, si banka sukseduese, të cilin kjo bankë nuk e ka dhënë. Me Shkresën “Vërtetim” të lëshuar prej saj në datë 12.6.2019 ajo shprehet se nuk disponon të dhëna në lidhje me llogaritë/depozitat përpara datës

1.10.2004. Nëse kjo bankë do të jepte informacionin e kërkuar për llogarinë në emër të nënës time {...}, atëherë do të vërtetohej plotësisht dhe ligjërisht se shuma prej rreth 2,000,000 Lekë, e tërhequr rreth vitit 2004 nga nëna ime, e pretenduar nga ILDKPKI si e pavërtetuar me dokumentacion të plotë ligjor, është krijuar nga kursimet e përfituara nga të ardhurat e aktivitetit tregtar, të depozituara për afërsisht përpara vitit 1997. Gjithashtu, pas refuzimit për dhënien e informacionit nga Raiffeisen Bank, nëna ime {...}, i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me të njëjtën kërkesë. Në shkresën “Kthim përgjigje” me nr. prot. 3253/1, dt. 28.06.2019, Banka e Shqipërisë është shprehur se ajo nuk ka trashëguar detyrimet e asnjë institucioni, përfshirë ato të ish Bankës së Kursimeve.

Kështu, si konkluzion shprehem se objektivisht unë e kam përmbushur barrën e provës për të vërtetuar se shuma prej rreth 2,000,000 Lekë që ka shërbyer si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të përshkruar më lart, rrjedh nga fitimet e përftuara nga depozita bankare në ish-Bankën e Kursimeve përpara vitit 1997, në të cilën fillimisht janë depozituar rreth 400,000 Lekë dhe janë tërhequr 2,000,000 Lekë rreth vitit 2004, të cilat janë ridepozituar në sistemin bankar deri në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2016”.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} iu kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13610/1 prot., datë 19.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepen të dhëna për aktivitet tregtar.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 18232/1 prot., datë 23.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t’iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

5. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të tij nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar përsa i përket kriterit të pasurisë, në referim të gërmës “a”, pika 4 e nenit 32 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 20 të Seksionit “A” të Kreut IX të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të KLGJ-së “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pasi ka rezultuar që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasurinë e tij.

5.1 Ashtu sikurse rezulton edhe në raportin e ILDKPI-së, as burimet financiare të kandidatit dhe as burimet e ligjshme financiare të prindërve të tij, nuk justifikojnë blerjen e apartamentit në pronësi të kandidatit z. {...}, pasi ashtu siç është analizuar gjerësisht në këtë raport, gjatë verifikimit të kryer, është konkluduar në mungesë të ekzistencës së dokumentacionit justifikues financiar për

të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve si tregtarë ambulant, të ardhura të cilat kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e apartamentit me vlerë 9.000.000 lekë.

5.2 Lidhur me pretendimin e kandidatit për depozitën fillestare prej 400.000 lekësh në ish-Bankën e Kursimeve, depozitë e cila kishte si burim fillestar kursimet nga veprimtaria tregtare e prindërve, prej së cilës janë gjeneruar edhe të ardhurat që rrjedhin nga interesat bankare që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, **rezulton se ky pretendim nuk u arrit të provohej**. Nga konfirmimet e marra nga ILDKPKI-ja prej të gjitha bankave të nivelit të dytë, sikurse referohet në raportin e kontrollit, fakti i pretenduar nga kandidati nuk vërtetohet. Po ashtu, edhe nga vërtetimi i paraqitur nga kandidati, marrë nga Raiffeisen Bank, si banka suksesuese e ish Bankës së Kursimeve, nuk konfirmohet fakti i pretenduar nga kandidati, ndërsa bëhet e ditur se kjo bankë nuk disponon të dhëna në lidhje me llogaritë/depozitat përpara datës 01.10.2004. Në këto kushte, rezulton se pretendimi i kandidatit z. {...} mbetet i pavërtetuar.

5.3 Këshilli vlerëson se, edhe në rast se analiza financiare e prindërve të kandidatit nga ana e ILDKPI-së, do të bëhej duke i konsideruar “*persona të lidhur*”, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” i ndryshuar, apo nëse do të analizohej dhe vlerësohej mundësia financiare e huadhënësve të prindërve (të afërmit dhe vajza/motra e kandidatit), rezultati i verifikimit në rastin konkret, eventualisht, mund të thellonte konstatimin negativ të arritur nga ILDKPI-ja dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke mos sjellë një situatë pozitivisht ndryshe për kandidatin nga ç’ka është konkluduar.

5.4 Bazuar sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, arrin në përfundimin se përsa i përket verifikimit të kriterit të pasurisë, në rastin konkret rezulton se kandidati {...} nuk arriti të kalojë me sukses këtë moment, pasi burimet financiare për krijimin e pasurisë së tij, më së paku nuk justifikohen për një vlerë prej 2.500.000 lekë, vlerë kjo tepër e lartë çka bën të pavend vënien në diskutim në këtë rast të parimit të proporcionalitetit.

Ç. Për kriterin e figurës

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e organeve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 09.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në

zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 2057/101 prot., datë 14.10.2019, Vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin deklarues {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se “*Subjekti deklarues {...} {...}, kandidat për gjyqtar, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6418/1 prot., datë 04.09.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, verifikohet që :

- a) *Kandidati ka plotësuar, depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;*
- b) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;*
- c) *për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) *për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;*

d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;

dh) për kandidatin nuk ka të dhëna të tjera të atilla në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilat të mund të konkludohet për papranueshmërinë e ndjekjes nga ai të programit të formimit fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës.

III. KONKLUZIONE

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit të ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se në këtë rast ekziston një shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar, që lidhet me kriterin e verifikimit të pasurisë së kandidatit. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për skualifikimin e kandidatit dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 4/a të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në shkronjën “b”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, në pikën 20 të Seksionit “A” të Kreut IX, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR